



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 33
04.12.2015

NR. VENDIMI 26
05.12.2015

V E N D I M .

“PER ZGJATJEN E AFTATIT TE SEKUESTROS”

Gjykata e Shkalles se Pare per Krimet e Renda Tirane, e perbere nga :

Gjyqtar : Klodian KURUSHI

Asistuar prej sekretares gjyqesore **Fjoralba KOLA**, sot me **date 05. 12. 2015**,
ora 10:00, zhvilloi gjykimin e kerkeses penale qe i perket;

KERKUES: Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Per Krime te Renda
Tirane,perfaqesuar nga **prokurorja Anisa QILIMI**.

OBJEKTI: Zgjatje te afatit te zbatimit te mases se sekuestrimit te pasurive.

KUNDER : Shtetasit Sh. B., në mungesë. .

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 date 03. 12. 2009 “Per Parandalimin dhe
Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet
Masave Parandaluese kunder Pasurise”.

Ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses te zhvilluar ne prani te prokurores Anisa
Qilimi e cila kerkoi: Pranimin e kerkeses, kjo gjykate pasi degjoi kerkimet dhe
shqyrtoi aktet e paraqitura:

VEREN:

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, ka paraqitur para kesaj gjykate kerkese per zgjatjen e afatit te mases se sekuestrimit per nje periudhe tre mujore te vendosur nga kjo gjykate me vendimin e saj nr. xx, date xxxx per pasurite qe i perkasin shtetasit Sh. B..

Prokuroria Per Krime te Renda Tirane per procedimi pasuror nr.x date xxxx ka filluar mbi bazen e referimit te bere nga Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare xxxx, me shkresen nr. xxxx prot xxxx, e cila heton procedimin penal nr.xxxx te vitit xxxx per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ne ngarkim te shtetasit E. B..

Sipas informacioneve te mbledhura nga Drejtoria e Policise se Qarkut xxxx ka rezultuar se shtetasit E. B. (i njohur dhe me gjeneralitetet B. B. dhe E. M.), i biri Sh., i datelindjes xxxx, lindur ne xxxx dhe I. K. (I. B.), i biri i Sh., i datelindjes xxxx, lindur ne xxxx, kane kryer investime ne fushen e ndertimit si dhe transakcione me shuma te konsiderueshme, te cilat dyshohen se jane produkt i aktivitetit kriminal te ushtruar prej tyre. Konkretisht, nga te dhenat e deritanishme ka rezultuar se shtetasi E. B. (B.) dhe i ndjeri, vellai i tij I. K. (i cili ka gjetur vdekjen ne muajin Gusht te vitit xxxx) kane ndertuar nje godine x-kateshe ne Lagjen "xxxx" xxxx, me destinacion resort turistik.

Ka rezultuar se, me lejen nr.xxxx date xxxx, shtetasi Sh. B., i ati i I. dhe E. B., eshte pajisur me leje legalizimi per objektin me nr.pasurie xxxx, z.k.xxxx me siperfaqe parcele ndertimore xxxx m², siperfaqe totale ndertimi xxxx m², numri i kateve mbi toke x. Lidhur me kete siperfaqe trualli rezulton se, me kontraten noteriale te kaparit nr.xxxx rep., nr.xxxx kol., date xxxxx, shtetasi Sh. B., ne cilesine e bleresit ka blere nga trashegimtarete e Sh. G. kete truall ne vleren xxxx euro. Ne kontrate percaktohet se shitesi ka paguar kestin e pare prej xxxx euro, ndersa shuma prej xxxx euro do te paguhet me date xxxx.

Nga organi procedues eshte bere kqyrja e vendit te ngjarjes, konkretisht e

objekti te ndertuar, te ciles i eshte bashkelidhur tabela fotografike nr.xxx date xxxx.

Gjithashtu eshte proceduar me ekspertimin vleresues te kesaj pasurie dhe nga akti i ekspertimit vleresues te kesaj pasurie konkludohet se, vlera e objektit te vleresuar sipas kosos se ndertimit per qytetin e xxxx, ne momentin e inspektimit ku objekti nuk eshte perfunduar por eshte ralizuar ne x % te volumit te ndertimit ka vleren xxxx leke. Konstatohet se punimet brenda ne godine nuk kane perfunduar. Po ashtu ne vleren e kosotos nuk eshte perfshire vlera e truallit.

Ne deklarimin e tij, shtetasi Sh. B. ka deklaruar se kjo pasuri eshte investim i te afermve te tij, konkretisht djemve te tij A. B., E. B. dhe I. K. qe nuk jeton me, ku secili ka vendosur te ardhura. Burime te ketyre te ardhurave jane siguruar nga shitja e bagetive te imeta qe Sh. B. ka patur per periudhen 1990-2006, si dhe te ardhurat e fituara nga puna ne emigrim e djemve te tij qe ne vitet '90. Lidhur me truallin ku eshte ndertuar objekti, ai shpjegon se djali i tij I. K. e ka blere nga M. G.. Me sa ka dijeni nga i ndjeri I. K., vlera e objektit ka shkuar rreth xxxx (xxxx) leke. Ai shpjegon se ne muajin dhjetor te vitit 2014 eshte pajisur me çertifikate pronesie per kete objekt. Po ashtu shpjegon, se ne vitet 2007-2008 djali i tij I. ka qene ne burg ne xxxx ose xxxx per rreth x vjet.

Ne deklarimin e tij shtetasi E. B. ka shpjeguar se, qe nga viti 1999 ka punuar si emigrant ne xxxx. Ne Shqiperi ka patur nje depozite ne vleren xxxx euro ne xxxx Bank. Ai nuk ka qene asnjehere i punesuar ne Shqiperi por te ardhurat i ka siguruar nga puna e tij jashte shtetit. Ai eshte arrestuar ne xxxx ne vitin 2011, ku ka bere x muaj burg. Po ashtu dhe vellezerit e tij kane qene te arrestuar jashte shtetit.

Nga ana e Prokurorise se Rrethit Gjyqesore xxxx eshte kryer hetimi pasuror ne lidhje me verifikimin e burimit te ligjshem te te ardhurave dhe pasurive ne emer te shtetasve te mesiperem si dhe per familjaret e tyre dhe nuk ka rezultuar qe keta persona te kene realizuar te ardhura te ligjshme qe te justifikojne burimin e ligjshem te investimit te kryer.

Ka rezultuar se ne emer te I. K. eshte rregjistruar shoqeria tregtare "xxxx" shpk, por kjo shoqeri tregtare rezulton se eshte regjistruar ne daten xxxx, ne kohen qe ndertimi i objektit ka perfunduar.

Nga informacioni i marre nga Zyra Nderlidhese Interforce xxxx eshte bere me dije se I. K. (B.) eshte arrestuar ne flagrante ne vitin xxxx per trafikim te lendeve narkotike dhe armembajtje pa leje. Rezulton se, me date xxxx ne ngarkim te I. K. eshte leshuar nje mandat arresti per deklarim te rreme ne lidhje me identitetin. Gjithashtu, me date xxxx, ky person eshte arrestuar ne flagrante per trafik te lendeve narkotike dhe armembajtje pa leje. Me date xxxx eshte liruar nga burgu me ane te Urdhrit nr.xxxx te dates xxxx te Prokurorise se Republikes ne xxxx.

Ne vijim, ndaj shtetasit I. K. eshte dhene masa e sigurise "Arrest ne burg" xxxx, e dates xxxx nga Gjykatesi i Hetimeve Paraprake prane Gjykates ne xxxx ne kuader te procedimit penal nr.xxxx xxxx per trafik lendesh narkotike. Gjykatesi i Hetimeve Paraprake prane Gjykates ne xxxx ka leshuar mase sigurie "Arrest ne burg" nr.xxxxx - Nr.xxxx xxx si dhe ka kerkuar nje mandat arresti europian per shkelje te neneve 73-74 xxxx dhe nenit 4 te ligjit 146/2006. Behet me dije se me date xxxx, ky shtetas eshte liruar nga burgu pasi Prokurori i Pergjithshem prane Gjykates se Kasacionit Rome ka urdheruar mbylljen e menjehershme te mases se sigurise "Arrest me burg".

Gjithashtu ne informacionin e derguar nga Zyra Nderlidhese Interforce xxxx rezulton se ndaj I. K. me date xxxx eshte caktuar masa e sigurise "Arrest ne burg" ne vijim te ekstradimit ne xxxx.

Gjithashtu nga te dhenat e ketij hetimi ka rezultuar se shtetasi E. B. ka qene i proceduar nga autoritetet e drejtesise ne xxxx, ku ka qene edhe i arrestuar per vepra penale te kryera ne fushen e narkotikeve.

Me date xxxx nga ana e organit procedues xxxx eshte proceduar me regjistrimin e emrit te E. B. si person nen hetim per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Per sa me lart, kur per shtetasin E. B. ka te dhena dhe dyshime se eshte e perfshire ne aktivitetin kriminal te “Trafikimit te narkotikeve”, dhe ai dyshohet per vepren penale te “Pastrimit te Produkteve te vepres penale” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ne kushtet kur edhe kompania “xxxx” shpk, shoqeri tregtare rezulton te jete regjistruar ne daten xxxx, pra pasi objekti i ndertuar nga shtetasi E. B. dhe vellai i tij i ndjeri I. B., shtetasi E. B. eshte subjekt i hetimit pasuror, bazuar ne nenin 3 pika 1/d te Ligjit “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”.

Per kete shtetas nga ana e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor xxxx jane identifikuar dhe eshte vendosur masa e sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” nga ana e Gjykata e Shkalles se Pare xxxx me vendimin nr. xxxx date xxxx mbi keto pasuri:

- Objekti truall me nr. pasurie me sip.parcele ndertimore xxxx m2 z.k xxxx, Lagja “xxxx” xxxx, me pronar Sh. B..
- Objekti ndertese x kate me sip.totale xxxx m2, me nr. pasurie xxxx, z.k.xxxx, Lagja “xxxx” xxxx, i regjistruar ne emer te shtetasit Sh. B..

Persa i perket pasurive te mesiperme rezulton se objekti pese katesh ne zonen e “xxxx” eshte legalizuar me lejen e legalizimit nr. xxxx date xxxx ne emer te shtetasit Sh. S. B., babai i te dyshuarit E. B.. Ndersa trualli rezulton te jete blere sipas kontrates noteriale nr. xxxx rep dhe xxxx kol date xxxx nga trashegimtaret e Sh. G., po nga shtetasi Sh. S. B., ku sipas vertetimit hipotekor me nr. xxxx dt xxxx, ky truall qe ndodhet ne zonen kadastrale me nr. xxxx dhe me sip xxxx m2, rezulton te jete regjistruar ne emer te shtetasit Sh. B..

Nga verifikimi i kryer ne Zyrat e regjistrimit te pasurive te paluajtshme shtetasi E. B. nuk rezulton te kete prona te regjistruara prane ketyre zyrove.

Te gjitha keto pasuri dyshohet se jane fituar nga te ardhurat e realizuara si rezultat i veprimtarise kriminale te kryer jashte shteti nga personi i hetuar E. (B.) B. (i njohur dhe me gjeneralitetet B. B. dhe E. M.), i biri Sh., i datelindjes xxxx, lindur ne xxxx

dhe i ndjeri vellai i tij I. K. (I. B.), i biri i Sh., i datelindjes xxxx, lindur ne xxxx.

Gjithashtu nga hetimi eshte provuar se keta te fundit dhe familjaret e tyre nuk kane te ardhura te cilat mund te justifikojne nje pasuri te tille.

Sa me siper keto pasuri plotesojne kriteret e parashikuara nga neni 11 i ligjit nr. 10192 date 03.12.2009, i ndryshuar “Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”, pasi se pari jane perfituar pas perfshirjes se personit ne veprimtari kriminale.

Se dyti, keto pasuri nuk i pergjigjen nivelit te te ardhurave te te dyshuarve dhe familjareve te tyre.

Se treti, ekziston rreziku i humbjes apo tjetersimit pasi ndaj vendimit te sekuestrimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor xxxx, mund te ankohen te interesuarit duke kerkuar revokimin apo moskonfiskimin e ketyre pasurive.

Nje kerkese te tille, prokurori e ben ne mbeshtetje te nenit 12/3 te Ligji nr. 10192 date 03/12/2009, “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”. Shtetasi Sh. B. ne kendveshtrim te ketij ligji eshte person i aferm i te dyshuarit E. B., i paralinduri, babai, sipas parashikimit te nenit 3 pika 2/a te tij.

Duke u mbeshtetur ne faktet e mesiperme, Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda, ne shkresen percjellese nr.xxxx date xxxx i eshte drejtuar kesaj gjykate me kerkese per vendosjen e sekuestros per shtetasin Sh. B.. Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, me vendimin e sak nr.xx,date xxxx ka vendosur pranimin e kerkeses si dhe sekuestrimin e pasurise si me poshte :

- Objekti truall me nr. pasurie me sip.parcele ndertimore xxxx m² z.k xxxx, Lagjia “xxxx” xxxx, me pronar Sh. B..
- Objekti ndertese x kate me sip.totale xxxx m², me nr. pasurie

xxxx, z.k.xxxx, Lagja "xxxx" xxxx, i regjistruar ne emer te shtetasit Sh. B..

Gjithashtu, vendimi i Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, nr.x,date xxxx, sipas shkreses nr.xxxx Prot, date xxxx eshte bere ne date xxxx, ora 11.30 nga ana e Zyres se Permbarimit xxxx dhe eshte mbajtur proces verbali perkates.

Ne kuader te hetimit pasuror te kryer ashtu sic dokumentohet nga permbajtja e fashikullit te organit te prokurorise jane nisur tre leterporosi per ndihme juridike perkatesisht ndaj autoriteteve italiane, belge dhe hollandeze.

Bashkelidhur shkreses percjellese Nr.xxxx, date xxxx ka rezultuar se eshte administruar kopje e njesuar e akteve te pergjigjes se kerkeses se organit te prokurorise per ndihme juridike drejtuar autoriteteve italiane te drejtesise administruar dhe ne fashikullin qe eshte vene ne dispozicion gjykates. Ne kete material te dhena me interes per hetimin ne drejtim te ekzistences se procedimeve penale dhe proceseve gjyqesore ndaj shtetasit E. (B.) B. (i njohur dhe me gjeneralitetet B. B. dhe E. M.), i biri Sh., i datelindjes xxxx, lindur ne xxxx dhe i ndjeri vellai i tij I. K. (I. B.), i biri i Sh., i datelindjes xxxx, lindur ne xxxx. Sa me siper dokumentohet plotesisht nepermjet akteve se shtetasi E. B. ka qene i perfshire ne veprimtari kriminale dhe ndaj tij jane zhvilluar disa procese gjyqesore penale. Gjithashtu ne fashikull jane administruar dhe akte nga Agjensia e te Ardhurave (Te dhenat anagrafike) Itali me rendesi per hetimin pasuror te subjektit ne fjale.

Nderkohe qe ende nuk jane administruar aktet e kerkeses per ndihme juridike drejtuar autoriteteve belge dhe atyre hollandeze. Administrimi i ketyre akteve paraqet rendesi per evidentimin e procedimeve penale, zgjidhjen ligjore te tyre dhe hetimin pasuror te shtetasve ndaj te cileve adresohet kjo ceshtje.

Per kete arsye, Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda, i eshte drejtuar kesaj gjykate me kerkese per zgjatjen per nje afat tre mujor te kesaj sekuestroje duke pretenduar si shkak verifikimet komplekse per shkak te instrumentave te ndihmes se ndersjellte juridike te cilat kerkojne kohe dhe jane te domosdoshme per zgjidhjen ligjor e korrekte te ceshtjes.

Gjykata vlereson se duhet te pranoje kerkesen e Prokurorise per Krime te Renda per zgjatjen e afatit te vlefshmerise se sekuestros se pranuar prej saj me vendimin nr.xx date xxxx.

Duke patur parasysh kerkesat e nenit 12/3 te Ligjit nr. 10192 date 03/12/2009, gjykata i vlereson si argumenta te mjaftueshme ato te dhena nga Prokuroria Per Krime te Renda, per tu konsideruar verifikime komplekse per hetimin pasuror.

Mbi kete baze me kerkese te pales paditese vendos zgjatjen e afatit te zbatimit te sekuestros se caktuar prej saj me vendimin nr. xxx date xxxx per nje periudhe tre mujore.

PËR KËTO ARSYE .

Gjykata bazuar në nenet 3, 7, 11, 12,14,15 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009 "*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive*"

VENDOSI

- Pranimin e kerkeses se Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.
- Zgjatjen afatit te zbatimit te sekuestros se pasurise se sekuestruar me vendimin Nr. xx date xxxx te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane per nje periudhe tre mujore, duke filluar ky afat te pasurive si me poshte:
 - Objekti truall me nr. pasurie me sip.parcele ndertimore xxxx m² z.k xxxx, Lagja “xxxx” xxxx, me pronar Sh. B..
 - Objekti ndertese x kate me sip.totale xxxx m², me nr. pasurie xxxx, z.k.xxxx, Lagja “xxxx” xxxx, i regjistruar ne emer te shtetasit Sh. B..
- Urdherohet sekretaria gjyqesore e kesaj gjykate te njoftoje menjehere per kete vendim administatorin e pasurise z.E. B., i cili eshte

administrator i Angjencise per Administrimin e te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

- Per ekzektimin e ketij vendimi te ndarkohet Zyra e Permbarimit xxxx.
- Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërme e shpalljes për palen e pranishme, ndërsa për palët në mungesë, ky afat fillon nga dita e marrjes dijeni për vendimin.

U shpall ne Tirane me date 05. 12. 2015.

SEKRETARE

Fjoralba KOLA

GJYQTARI

Klodian KURUSHI

